



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 116, datë 09.08.2019

PËR PEZULLIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË KANDIDATURAVE DHE NJOFTIMIN E SUBJEKTIT QË E KA VËNË NË LËVIZJE, PRESIDENTIN E TË REPUBLIKËS, PËR TË VLERËSUAR RISHPALLJEN E THIRRJES PËR PARAQITJEN E KANDIDATURAVE PËR PLOTËSIMIN E VENDIT VAKANT NË GJYKATËN KUSHTETUESE, VAKANCË E PARAKOHSHME, TË SHPALLUR ME DEKRETIN NR. 10723 DATË 07.02.2018 NGA PRESIDENTI I REPUBLIKËS

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 125 dhe pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 7/b të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 229 dhe pikës 1 të nenit 234 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të pikës 32 dhe shkronjës “a” të pikës 49 të Vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

1. Pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidaturave dhe njoftimin e subjektit që e ka vënë në lëvizje, Presidentin e Republikës së Shqipërisë, për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur me Dekretin nr. 10723 datë 07.02.2018 nga Presidenti i Republikës.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.



KRYETARI

Ardian Dvorani